

Little Human Limited SHPK
Rr Abdi Toptani, Toptani Shopping Center, kati 4
Tiranë, Shqipëri
L91425025G

VENDIM I MBLEDHJES SË ASAMBLESË

LITTLE HUMAN LIMITED SHPK

Sot, më datë 11 shtator 2019, në Tiranë, pranë Rezidenca Kodra e Diellit, më datë 11 shtator 2019, ora 9:15 am, u mbledh asambleja e ortakëve të saj me praninë e:

1. **Iva Nathanaili**, ortake në masën **60%** të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë;
2. **Juna Nathanaili**, ortake në masën **10%** (dhjetë për qind) të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë
3. **Alba Cane**, sipas letërnjoftimit bashkangjitur, në cilësinë e personit të ftuar
4. **Florjan Piperi**, sipas letërnjoftimit bashkangjitur, në cilësinë e personit të ftuar.

Ortakja Jorina Kadare, megjithëse ka marrë njoftim rregullisht për mbledhjen e asamblesë me postë elektronike, sic parashikon statuti dhe ka konfirmuar pjesëmarrjen në këtë mbledhje me postë elektronike, nuk ka marrë pjesë në mbledhje.

Rendi i ditës:

- 1) Rritja e kapitalit të nënshkruar me anë të emetimit të 1 (një) kuote të re dhe miratimi i nënshkrimit të kuotës;
- 2) Rritja e kapitalit të nënshkruar me anë të kontributit të vet ortakëve;
- 3) Ndryshimi i nenit 5të Statutit të Shoqërisë.
- 4) Rishikim dhe diskutim mbi modalitetet e thirrjes se asamblese se Shoqerise

Kuorumi: Rezulton i krijuar kuorumi i nevojshëm për çështjet që kërkojnë një shumicë të cilësuar në rend dite si rritja e kapitalit dhe ndryshimi i statutit. Konkrektisht, sipas nenit 11.8 te Statutit duhet te jene te pranishem 60% e ortakëve per te marre vendime te vlefshme.

Vendimet që u morën në këtë mbledhje:

- 1) Miratimi i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë me një vlerë shtesë prej 220 LEK (dyqind e njëzetë lekë) nëpërmjet emetimit të 1 (një) kuote të re. Si rrjedhim, kapitali i shoqërisë ndahet në 4 (katër) kuota. Kuota e re do të nënshkruhet, shlyhet e zotërohet tërësisht nga **Alba Cane**, në vlerën shtesë të kapitalit prej 220 lekë (dyqind e njëzetë) lekë.
- 2) Miratimi i zmadhimit të kapitalit të shoqërisë me anë të kontributeve shtesë nga ortakët ekzistues Iva Nathanaili në vlerën shtesë prej 190 Leke (njëqind e nëntëdhjetë lekë) dhe Juna Nathanaili në vlerën shtesë prej 10 (dhjetë) lekë. Si rrjedhim, kontributi i Iva Nathanaili nga vlera 600 lekë rritet në vlerën 790 lekë dhe kontributi i Juna Nathanailit nga vlera 100 leke rritet në 110 lekë (njëqind e dhjetë).
Si rrjedhim i rritjes totale të kapitalit të shoqërisë në vlerën totale shtesë prej LEK 420 (katërqind e njëzetë lekë), kapitali i shoqërisë rritet nga LEK 1000 (njëmijë) në LEK 1420 (njëmijë e katërqind e njëzet) lekë dhe është i nënshkruar nga ortakët si më poshtë në raport me kapitalin themeltar të Shoqërisë:



Little Human Limited SHPK
Rr Abdi Toptani, Toptani Shopping Center, kati 4
Tiranë, Shqipëri
L91425025G

Iva Nathanaili: zotëron 1 kuotë, e barabartë me 56%
Jorina Kadare: zotëron 1 kuotë, e barabartë me 21%
Alba Cane: zotëron 1 kuotë, e barabartë me 15%
Juna Nathanaili: zotëron 1 kuotë e barabartë me 8%.

- 3) Ortakët vendosin të ndryshojnë nenin 5 të Statutit të Shoqërisë nga përmbajtja aktuale në përmbajtjen si më poshtë:

"Neni 5 – Kapitali"

5.2 Kapitali i Shoqërisë është 1420 Lekë (njëmijë e katërqind e njëzetë), i përbërë nga 4 (katër) kuota ndarë si më poshtë:

- Iva Nathanaili zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 56% (pesëdhjetë e gjashtëpërqind) të kapitalit themeltar;
- Jorina Kadare zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 21% (njëzetë e njëpërqind) të kapitalit themeltar;
- Alba Cane zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar
- Juna Nathanaili zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 8% (tetëpërqind) të kapitalit themeltar

5.2 Lidhur me pjesëmarrjen e secilit ortak në kapitalin e Shoqërisë, përveç kontributit në para, do të vlerësohet edhe kontributi në punë dhe shërbime i secilit prej tyre në mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë."

Emri

Nënshkrimi

Iva Nathanaili

Iva Nathanaili

Iva Nathanaili

Jorina Kadare

Alba Cane

Alba Cane

Jorina Kadare

Juna Nathanaili

Juna Nathanaili

Në prani

te personit

te fuqar: Florian Piperi

Florian Piperi

Little Human Limited SHPK
Rr Abdi Toptani, Toptani Shopping Center, kati 4
Tiranë, Shqipëri
L91425025G

Listë e pjesëmarrësve:

Në Tiranë, në mbledhjen e asamblesë së ortakëve të shoqërisë Little Human Limited SHPK, mbajtur në selinë e shoqërisë më datë 11 shtator 2019, ishin të pranishëm:

1. Iva Nathanaili
2. Alba Cane
3. Juna Nathanaili
4. Florjan Piperi

Emri

Nënshkrimi

Iva Nathanaili

Iva Nathanaili

Alba Cane

Alba Cane

Juna Nathanaili

Juna Nathanaili


Florjan Piperi

Florjan Piperi

Alba Cane

Kerlesë për mbijlljen e
NIPT-IT SEKONDAR

Pas përfundimit të qëllimit për
hapjen e NIPT-it shkollor,
herëz mbijlljen e adresës dytësore,
të hapur përkohësisht të kështjës
Liqenit, Tirana (Weekend in the Park).

Administratore
IVA NATHA NAILI,
Ive Nathanael,


Datë: 18 shtator 2019